

VENDIM
Nr.289, datë 15.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.55, DATË 26.1.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË
TË PËRKOZHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.55, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore, bëhet 1351 veta. Shtesa prej 86 punonjësish është dhënë me hollësi sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Në lidhjen nr.2, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime:

Emërtesa “preparatore”, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, zëvendësohet me emërtesën “arkiviste” dhe emërtesa “arkiviste” zëvendësohet me emërtesën “preparatore”.

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2011 të njësive të qeverisjes qendrore.

4. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë me hollësi numrin e punonjësve sipas lidhjes nr.4, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha